



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 05/1 Prot.

Tiranë, më 15.01.2026

VENDIM

Nr. 3, datë 09.01.2026

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT SI DREJTUES I PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË, Z. ARENS ÇELA”**

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 95 dhe 96, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 159, pikat 1 dhe 2, germa “a”, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “a” dhe 190, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe Vendimin nr. 380, datë 30.11.2023, “Për miratimin e Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe pasi u njoh me projektraportin e përgatitur nga Relatori, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. Arens Çela, për periudhën 11.10.2022 – 11.10.2025, duke e vlerësuar si më poshtë:
 - a. Aftësitë drejtuese dhe organizative – “Mbimesatare” – 100 (njëqind) pikë;
 - b. Aftësitë komunikuese – “Mbimesatare” – 98 (nëntëdhjetë e tetë) pikë;
 - **Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë” – 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) pikë**
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit, për shkelje të rënda procedurale.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në përputhje me nenin 95, pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

U shpall në Tiranë, sot më 09.01.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla